



QEVERIA E REPUBLIËS SË MAQEDONISË
Agjesnioni për administrim me mallin e konfiskuar
rr.Maqedonia p.n.- 1000 Shkup

PLANI STRATEGJIK I AGJESNIONIT PËR ADMINISTRIM ME MALLIN E
KONFISKUAR(2014 – 2016)

Shkup, Gusht 2013

1. Hyrje

1. Agjensioni për administrim me mallin e konfiskuar është institucion shtetëror Qeveritar i cili është e pavarur në punën e tij, kurse të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tij i zbaton në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Maqedonisë, dispozitat e Statutit të tij si dhe rregulla dhe akte të përgjithshme të tij.

Agjensioni për administrim me pronën e konfiskuar pamvarësisht i rregullon marrëdhëniet e mbrendshme, si dhe marrëdhëniet në plan ndërkombëtar, me kusht dhe mënyrë të përcaktuar me Ligj.

2. Statuti i përcakton synimet, objektivat dhe aktivitetet e Agjensionit për administrim me pronën e konfiskuar, karakterin dhe vendin, mënyrën e ekzekutimit, organizimin e brendshëm të Agjensionit, përgjegjësitë e Këshillit drejtues dhe Drejtorit, mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Këshillit drejtues, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve, bashkëpunim ndërkombëtar i Agjensionit dhe çështje të tjera të rëndësishme për veprimtarinë e Agjensionit.

Agjensioni për administrim me mallin e konfiskuar vepron në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe më gjerë.

3. Plani Strategjik i Agjensionit për administrim me pronën e konfiskuar (në tekstin e mëtejme: Agjensioni) është një dokument thelbësor në procesin e planifikimit strategjik dhe ofron vizion strategjik të Agjencisë në tre vitet e ardhshme.

4. Plani Strategjik i Agjensionit ofron plotësimin e planeve të sektorëve organizativ në drejtim të kryerjes në mënyrë efektive të qëllimeve të përcaktuara dhe fushëveprimin e Agjensionit.

5. Plani Strategjik i Agjensionit përcakton misionin, vizionin për të ardhmen, vlerat organizative dhe qëllimet strategjike dhe prioritetet e Agjensionit, burimet e nevojshme dhe burimet financiare për zbatimin e tyre, si dhe rezultatet e arritura dhe rezultatet e pritura.

2. Misioni

Agjensioni për administrimin e pronës së konfiskuar do të vazhdojë të jetë organ efektiv në luftën kundër krimit dhe do të jetë plotësisht i angazhuar për gjetjen e të ardhurave nga krimi, konfiskimin e pronës, menaxhimin efektiv, shitjen dhe zbatimin e të ardhurave në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

3. Vizioni

Agjensioni për administrim me pronën e konfiskuar në përputhje me parimet e ligjshmërisë, ekonomisë, efikasitetit, transparencës, trajtimin e kujdesshëm të shtëpiakut të mirë, përgjegjësisë, llogaridhënies, profesionalizmin dhe zellshmërisë do të krijojë një sistem të shërbimit civil përgjegjës dhe të përgjegjshëm në aspektin e administrimit, lëshimin(dhënien), shitja e pronës së konfiskuar, mallin dhe sende të konfiskuara.

4. Detyra dhe obligime të Agjencionit

- Në bazë të Ligjit, Agjensioni ka autoritet për të kryer detyrat e mëposhtme:
- të administrojë me pronën e konfiskuar, mallin dhe sendet e konfiskuara
 - me pëlqimin e gjykatës dhe organit kompetent administron me pronën përkohësisht të konfiskuar dhe mallin përkohësisht të konfiskuar, dhe sendet përkohësisht të konfiskuara me qëllim të mbrojtës së vlerës së pronës në përputhje me këtë ligj,
 - zbaton ekzekutimin sendeve dhe mallit të konfiskuar,
 - e ruan dhe e vendos pronën e konfiskuar
 - bën vlerësimin,
 - mban evidencë të të gjithë pasurisë së konfiskuar,
 - e shet pronën e konfiskuar
 - përgatit raporte statistikore, financiare dhe raporte të tjera për pasurinë e konfiskuar
 - planifikon, organizon dhe kryen trajnime për punonjësit e Agjencionit dhe subjekteve të tjerë të përfshirë në trajtimin e pasurisë së konfiskuar
 - jep mendime për zbatimin e këtij ligji dhe të
 - kryen detyra të tjera të caktuara me ligj.

5. Specifikat e Agjensionit për administrim me pronën e konfiskuar

Specifika e Agjensionit për administrim me pronën e konfiskuar rrjedh nga konfiskimi i produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Operacioni i tillë është duke kontribuar më shumë pozitivitet në kuadër të shtetit dhe më gjerë, në të njëjtën kohë bën reduktimin e korrupsionit dhe aktiviteteve kriminale që përmirësojnë flukse ekonomike dhe në këtë mënyrë përmirëson dhe standardet e popullsisë.

6. Struktura e Agjensionit për administrim me mallin e konfiskuar

Në bazë të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe Rregullores për sistemimin e punëtorëve të Agjensionit, të themeluara janë themeluar tre sektorë

- Sektori për çështje ligjore, përbëhet nga tri njësi:
 - Njësia për zbatimin e vendimeve
 - Njësia e çështjeve normative dhe ligjore
 - Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar

- Sektori i çështjeve financiare, përbëhet nga dy njësi:
 - Njësia e kontabilitetit dhe pagesat
 - Njësia për koordinimin buxhetor dhe kontrollin e buxhetit

- Sektori për punë operative, përbëhet nga pesë njësi:
 - Njësia për të marrë pronën e konfiskuar
 - Njësia për vlerësimin e pronës së konfiskuar
 - Njësia për organizimin e punës së punonjësve publik
 - Njësia për shitjen e pronës së konfiskuar dhe furnizim
 - Njësia për mbështetje logjistike

si dhe dy njësi të veçanta:

- Njësia për resurset njerëzore
- Njësia për revizion të brendshëm

7. Prioritetet e Agjencionit për administrim me pronën e konfiskuar

Objektivat prioritarë janë të vendosura në bazë të vizionit të përcaktuar qartë për nevojën e kontrollit, menaxhimit, asgjësimit, dhe shitjes së pronës së konfiskuar.

- mbledhja e plotë dhe regjistrimi i gjithë pasurisë së konfiskuar nga gjykatat, drejtoria doganore, policia dhe organet e tjera të inspeksionit,

- Vendosje e depove dhe magacinave në rajone të disa qyteteve të tjera në vend të cilat do të kontribuojnë në funksionimin më efikas, si dhe marrje e mallit sa më shpejt dhe ruajtjen e mallrave të konfiskuara sa më ekonomikisht dhe uljen e kostot të transportit dhe përmirësimin e koordinimit me institucionet tjera relevante,

- Rritja e kapacitetit të magacinave me qëllim të ruajtjes së përshtatshme dhe mbrojtjen e vlerës së sendeve të sekuestruara,

- Sigurimi i depove dhe magacinave me aparatet për mbrojtjen nga zjarri, si dhe pajisjet e duhura teknike si kamera, kompjutera, sistem alarmi dhe gjithçka që është e nevojshme për funksionimin normal të një depoje,

- krijimi i kushteve dhe fillimi i shitjes së pronës së konfiskuar

- Dhënia pa kompensim pronat e konfiskuara për nevojat e organeve të tjera shtetërore dhe institucioneve , fondacioneve dhe subjekteve të tjera në përputhshmëri me Ligjin,

- Rritja e të ardhurave në bazë të mallit (patundshmërive) të konfiskuar ,

- Bashkëpunimi me agjencionet e njëjta jashtë shtetit dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare ,

- Mbindërtimin e sofverit për kontabilitet, mbindërtimin e veb faqes, softver për arhivë dhe evidentimin e pasurisë së sekuestruar

- Përmirësimi , edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i resurseve njerëzore,

- Përmirësimin e funksionimit dhe organizimin e agjencisë,

- Pajisje e plotë të stafit dhe ekipit hapësinor, pajisjeve teknike dhe programuese,
- Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit ekzistues,
- Zbatimin e ISO 9001:2008 standardeve për cilësi

8. Shqyrtimi i rezultateve të arritura dhe të pritshme në 2013

Gjatë vitit 2013 agjensioni për të justifikuar krijimin dhe ekzistencën Agjensioni e rriti anën e të ardhurave të buxhetit në shtet me mbi 2.000.000 (dy milionë) ,të realizuara në bazë të pagimit të vendimeve gjyqësore të plotfuqishme.

Agjensioni e ka forcuar besimin e qytetarëve në shtet .

Ndihmoi në përforcimin e kapaciteteve të institucioneve përmes dhënies të automjeteve, dhënies të mallrave të llojeve të ndryshme – të mira materiale , veçanërisht theksojmë ndihmën që i'a dha Agjensioni Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (tekstil , mallrave teknike , veshje për të prekurit nga përmbytja).

9. Shqyrtimi i arritjeve dhe rezultateve të hapura në vitet e ardhshme

Në periudhën e ardhshme, Agjensioni pritet të vazhdojë pa probleme dhe të ushtrojnë në mënyrë efikase kompetencat e saj të përcaktuara me ligj, për të rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera që të arrijë në mënyrë efektive qëllimet dhe synimet të përcaktuara, për të marrë funksionalitetin maksimal në bazë të aftësive financiare, personelit dhe pajisjes me pajisje teknike.

Agjensioni do të marrë të gjitha masat për të mbajtur vlerën e pronës, duke e vendosur atë në proporcion të duhur në depo në përputhshmëri me nevojat, si dhe shitjen dhe administrimin me pronën e ngrirë. Këtë masë që do ta zbatojë Agjensioni varet prej llojit të pronës (të holla, aksione, mallrave, automjete, pasurive të patundshme, etj).

Një nga qëllimet dhe angazhimet e Agjensionit është krijimi dhe bashkëpunimi me institucionet e lidhura dhe agjensionet e vendeve të rajonit, për të shkëmbyer përvojat për punë më efikase në pajtueshmëri me ligjet dhe standardet ndërkombëtare.

Agjensioni do të vazhdojë të intensifikojë bashkëpunimin me organet dhe institucionet e tjera në vend për qasje të shpejtë dhe efikase për të shkëmbyer informacion dhe konfiskimin e pasurisë së personave të dënuar të cilët kanë realizuar të ardhura me krim.

10. Vërejtjet përmbyllëse

Zbatimi i Planit Strategjik të Agjensionit për administrim me pronën e konfiskuar (2014-2016) do të kontribuojë në përmirësimin e funksionimit të AAMK, në drejtim të menaxhimit efektiv të sendeve të sekuestruara dhe pronës sëkonfiskuar, dhe të ardhurat e shitjes së saj në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë ,që është qëllimi kryesor i AAMK-së.

Sa i përket implikimeve fiskale që do ti bëjë zbatimi i këtij Plani Strategjik,Buxheti i Agjensionit për administrim me pronën e konfiskuar, do të duhet të rritet të paktën 3 herë në funksion të realizimit të synimeve strategjike prioritare dhe të mbulojnë shpenzimet më themelore për funksionimin dhe ekzekutiimn e kompetencave të AAMK-së.